



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES



12-18 MAJ

JAVA E MBROJTJES





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

LÉCORNU NË “SHTËPINË” E MBROJTJES

Ministri i Mbrojtjes **Pirro Vengu** priti në një takim zyrtar homologun e tij francez **Sébastien Lecornu**, në të parën vizitë të një **ministri** të Forcave të Armatosura të Francës në vendin tonë. Në përfundim të **takimit**, dy ministrat nënshkruan **marrëveshjen** teknike për blerjen e sistemit të vëzhgimit ajror nga një kontraktor **industrial** francez.





SHQIPËRIA DHE BRITANIA E MADHE, MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Shqipëria dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar nënshkruan marrëveshjen për forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e Mbrojtjes. Firmosja u bë në prani të kryeministrit Edi Rama, kryeministrit sir Keir Starmer, ministrit të Mbrojtjes së Shqipërisë, Pirro Vengu dhe përfaqësuesve të lartë të dy qeverive në një ceremoni të mbajtur në kryeministri.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

KREU I NATO-S, MARK RUTTE NË TIRANË

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu ishte pjesë e takimit të Kryeministrit Edi Rama me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, i cili ndodhej në Shqipëri në kuadër të Samitit të Komunitetit Politik European që u mbajt në Tiranë. Në përgatitje të Samitit të ardhshëm në Hagë të pranishmit diskutuam mbi forcimin e mëtejshëm të rolit të Shqipërisë në Aleancë, sfidat e sigurisë në rajon dhe kontributin tonë aktiv në NATO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

KRYEMINISTRI BRITANIK VIZITON QENDRËN E INOVACIONIT

Gjatë vizitës së parë zyrtare të një kryeministri britanik në vendin tonë, kreu i qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar sir Keir Starmer vizitoi edhe Qendrën e Inovacionit dhe Muzeun e Forcave të Armatosura, ku u prit nga ministri Mbrojtjes Pirro Vengu dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralletënat Arben Kingji. Ministri Vengu dhe kryeministri Starmer panë mjediset e këtij kompleksi, ku u takuan edhe me ushtarakë shqiptarë dhe britanikë. ★★★★★

MINISTRI VENUGU NË TRYEZËN PËR MBROJTJEN EUROPIANE

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu bashkë-drejtoi tryezën për sovranitetin e mbrojtjes europiane në kuadër të Samitit të Komunitetit Politik European dhe konferencës ndërkombëtare “Future Investment Initiative” të mbajtura në Tiranë. Vengu theksoi angazhimin e Shqipërisë për forcimin e mbrojtjes kolektive.





GJENERALLEJTËNANT KINGJI, NË KOMITETIN USHTARAK TË NATO-S

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, në Bruksel. Në fokus të diskutimeve ishte ecuria e misioneve dhe operacioneve të NATO-s për sigurinë e zonës euroatlantike, rëndësia e planeve të mbrojtjes, rritja e investimeve në mbrojtje dhe inovacion, si dhe vijimi i mbështetjes për Ukrainën.

★★★★★




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



ZËVENDËSMINISTRJA E MBROJTJES, VIZITË NË KOMPANINË LEONARDO

Zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. **Blerina Abrazhda**, kryesoi një delegacion zyrtar në **Itali**, ku zhvilloi një vizitë dyditore pranë kompanisë ndërkombëtare “**Leonardo**”, një nga liderët globalë në **teknologjinë** e mbrojtjes dhe sigurisë. Vizita kishte për qëllim forcimin e **bashkëpunimit** me “Leonardon”, një partner strategjik për modernizimin e **kapaciteteve** mbrojtëse të vendit, dhe **dixhitalizimin** e infrastrukturës.





NIS MË 25 MAJ NGA SHQIPËRIA, STËRVITJA “DEFENDER EUROPE ‘25”

Më 25 maj do të nis zyrtarisht nga Shqiperia stërvitja shumëkombëshe “Defender Europe 25”, e drejtuar nga Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara (USEUCOM), një nga stërvitjet ushtarake më të mëdha në dekadat e fundit në Evropë dhe Afrikë. Stërvitja do të zgjasë deri më 9 qershor dhe synon të rrisë gatishmërinë, ndërveprueshmërinë dhe aftësinë për të vepruar në mënyrë të koordinuar me forcat te SHBA-së, NATO-s dhe vendeve partnere.

★★★★★



EFEKTIVËT E FA ME MISION NË BULLGARI

Efektivët e Regjimentit të **Këmbësorisë** së Jugut të Forcës Tokësore, të **dislokuar** në Novo Selo, Bullgari, në kuadër të misionit eVA 05, zhvilluan **veprime luftarake** në qendra të banuara, në nivel **grupbatalioni**, krah për krah me trupat e NATO-s. Stërvitja, pjesë e grupbatalionit **FLF BGR BG** (Forward Land Force, Battle Group, Bulgaria), **synon** rritjen e **ndërveprueshmërisë** dhe aftësisë për të vepruar së bashku në situata reale.

★★★★★